

NJOFTIM PËR SUBJEKTIN E RIVLERËSIMIT, ZNJ. SONILA MUHAMETAJ (DOMI)

10/25/2019

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit njofton se, pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe zhvillimit të seancës dëgjimore më datë 21.10.2019 për subjektin e rivlerësimit, znj. Sonila Muhametaj (Domi), bazuar në ligjin nr. 84/2016, sot, më datë 25.10.2019, vendosi:

Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, Sonila Muhametaj (Domi), prokurore pranë Prokurorisë së Krimeve të Rënda Tiranë.

Vendimi i arsyetuar me shkrim nga trupi gjykues i kryesuar nga znj. Genta Tafa (Bungo), znj. Etleda Çiftja relatore, znj. Suela Zhegu anëtare, do t'u njoftohet subjektit të rivlerësimit, komisionerëve publikë dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve.

Ndaj këtij vendimi, mund të ushtrohet ankimi pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.